



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

AD.GjKK.nr.02/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Autoriteti Kompetent - Kryetari Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Marigona I.Gashi e autorizuar e kreditorit J.M. – pronar i Eli Therm sh.p.k., për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës së Dhomave të Shkallës së Parë – V.D., me pretendimin për shkelje ligjore dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 02.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga Marigona I.Gashi avokate - përfaqësuesja e autorizuar e kreditorit J.M. – pronar i Eli Therm sh.p.k. ndaj gjyqtarës së Gjykatës Komerciale – V.D., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, më 20.08.2024 përmes parashtrësës, ka pranuar nga J.M. – pronar i Eli Therm sh.p.k., përmes përfaqësueses së autorizuar – avokate Marigona I.Gashi, ankesën/kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj V.D. - gjyqtare në Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Në ankesën për inicim të procedurës disiplinore parashtruesi, pretendon se gjyqtarja V.D., në çështjen juridike përmbartimore, e cila është duke u zhvilluar pranë kësaj gjykate, e evidentuar si: KPPP.nr.16/24, me palë kreditore "Eli Therm" sh.p.k ndaj palës debitore "Princesha Construction" sh.p.k., pas parashtrimit të disa urgjencave me kërkesë për përshpejtimin e kësaj lënde, gjykata më 28.05.2024, ka nxjerr aktvendim me të cilin ka hedh poshtë si të pasafatshëm prapësimin e palës debitore, ndërsa me këtë vendim nuk ka vendosur lidhur me garancionin të cilin duhet ta paguaj me rastin e paraqitjes së ankesës apo shpenzimet e procedurës.

Parashtruesi i kërkesës për inicim të procedurës, pretendon se: *“Më datë 23.07.2024, nga gjykata kemi pranuar ankesën kundër këtij aktvendimi, të ushtruar nga pala debitore të dt.03.07.2024. Ne, pas pranimit të kësaj ankese me dt.24.07.2024, i është drejtuar gjykatës me një parashtrëse me të cilën ka kërkuar të informohet lidhur me deponimin e garancionit nga pala debitore dhe ka lutur gjyqtaren që të zbatohet dispozitat në fjale, pasi që çdo javë që kalon për shkak të zvarritjeve të gjykatës pala kreditore që përfaqëson rrezikon të humbas të drejtën e tij në tërësi dhe dëmet financiare janë të majme”.*

Tutje në ankesë ka theksuar se: gjyqtarja e ngarkuar me këtë çështje me këto veprime dhe vendime, ka bërë shkelje disiplinore nga LPDGJP, ka shkel detyrat e saj zyrtare si gjyqtare, duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke mos zbatuar dispozitat Ligjore në fuqi përkatësisht nenin 78 të LPP-se. *“Gjë që na shtyn të dyshojmë në paanshmërinë e gjykatës si dhe diskriminim dhe trajtim jo të barabartë të palëve në procedurë. Meqenëse e njëjta as në vendim e as pas marrjes së Aktvendimit nuk e ka zbatuar këtë nen fare, duke mos e obliguar palën debitore të deponoj shumën sipas dispozitave ligjore imperative, por të njëjtit i trajtohet Ankesa në kundërshtim me dispozitat ligjore, edhe pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një të drejtë të tillë”.*

Sipas ankesës pretendohet se gjyqtarja V.D., në të njëjtën mënyrë, ka filluar të veproj edhe me lëndën tjetër përmbartimore të palës kreditore të njëjtë kundrejt debitorit të njëjtë, Aktvendim me shenjen KPPP nr.20/21, dt. 31.07.2024.

Në kërkesën për inicim të procedurës, parashtruesi pretendon se gjyqtarja e ngarkuar me këtë çështje ka bërë shkelje disiplinore, zbatim të dispozitave ligjore sipas dëshirës dhe në dobi të njëres

palë, ka qenë e njëanshme dhe se këto veprime kanë edhe elemente të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës, më datë 29.09.2024 bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka kërkuar nga gjyqtarja V.D. deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Më 30.09.2024, gjyqtarja V.D. në deklaratën e dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën për iniciimin e procedurës disiplinore, ka deklaruar se është thellësisht e bindur se nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore dhe nuk ka asnjë bazë për iniciim të procedurës disiplinore, përveç tendencës për njollosje të emrit të saj, pozitës që mban dhe presionit nga pala kreditore që të veprohet në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe palës debitore t`i pamundësohet e drejta e paraqitjes së ankesës.

Gjyqtarja V.D., lidhur me pretendimet në ankesë për shkelje të ligjit me rastin e marrjes së vendimit KPPP.nr.16/24, ka deklaruar se ndaj këtij aktvendimi, debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Përmbartimore lidhur me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ankesën e palës debitore, ia ka dërguar për përgjigje palës kreditore. *“Në rastin konkret, pala kreditore, ankesën e debitorit e ka pranuar me datën 23.07.2024, ndërsa ndaj të njëjtës parashtrësë/ankesë nuk ka paraqitur fare përgjigje, mirëpo, përmes parashtrësës së datës 24.07.2024, përfaqësuesja e kreditorit, i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar informacion lidhur me deponimin e garancionit nga pala debitore.*

E njëjta përmes parashtrësës së datës 12.08.2024, ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarës së rastit, me pretekstin se është shkelur ligji dhe i ka shkelur detyrat e saj zyrtare si gjyqtare, duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, duke mos zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht nenin 78 të LPP-së, (me rastin e mos caktimit të garancionit ndaj ankesës së debitorit të paraqitur ndaj vendimit me të cilin është hedhur poshtë si i pasafatshëm prapësimi i debitorit).

Në deklaratën me shkrim gjyqtarja V.D. ka deklaruar: “Edhe pse në përmbajtjen e kësaj ankese, nuk është paraqitur as edhe indicia më e vogël se unë kam kryer shkelje disiplinore, megjithatë po e marr mundimin që shkurtimisht të interpretoj dispozitën e nenit 78 të LPP-së dhe të sqaroj se në cilat raste aplikohet kjo dispozitë.

Sipas nenit 78 paragrafi 1 të LPP-së, përcaktohet që: “ Gjykata e shkallës së parë, në rastet kur debitori dëshiron të parashtrijë ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, urdhëron palën ankuese që të paguajnë garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm të pariparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë”.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, rezulton që garancitë për ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin për një kredi në bazë të dokumentit të besueshëm, caktohen vetëm në rastet kur refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit. Pra vetëm në rastet kur vendoset në mënyrë meritore nga ana e Gjykatës lidhur me prapësimin e debitorit, atëherë gjykata e shkallës së parë është e obliguar që nëse paraqitet ankesë, fillimisht duhet të caktoj garancionin, si parakusht që ankesa të mund të trajtohet nga gjykata më e lartë. Ndërsa për të gjitha rastet në të cilat është hedhur si i paafatshëm prapësimi i debitorit, por edhe në të gjitha rastet tjera kur është hedhur prapësimi i debitorit për cilëndo bazë të përcaktuar në Ligj, me rastin e paraqitjes së ankesës, asnjëherë nuk është caktuar garancioni, meqenëse një gjë e tillë nuk kërkohet sipas dispozitës ligjore të nenit 78 të LPP-së.

Gjyqtarja V.D., po ashtu ka sqaruar se edhe nga praktika e konsoliduar e Gjykatës Komerciale, gjykata edhe nëse ka caktuar garancione në shumën e plotë të kërkesës, me propozimin e palës debitore dhe me ofrimin e provave për gjendjen financiare të tyre, të njëjtit i ka liruar nga pagesa e pjesërishme e garancioneve apo edhe i ka liruar nga pagesa e garancionit në tërësi dhe iu ka mundësuar trajtimin e ankesës nga Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u bazuar në nenin 78 par.2 të LPP-së, ndërsa ka deklaruar se edhe në vendimet e shkallës së dytë të njëjtat ankesa janë trajtuar vetëm sa i përket pretendimeve lidhur me arsyet për të cilat është hedhur prapësimi, ndërsa të njëjtat vendime janë vërtetuar apo ankesat e debitorëve janë pranuar dhe çështja është kthyer ne rivendosje, thuhet në deklaratën e gjyqtares.

Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë dhe deklaratën e gjyqtarit, gjeti se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është e pabazuar dhe dukshëm joserioze. *“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimin të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”* – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti i Gjykatës Komerciale ka gjetur se pretendimet e paraqitura në ankesën për iniciim të procedurës disiplinore jo vetëm që nuk mund të konsiderohen si shkelje disiplinore siç pretendohet në ankesë, por nga parashtrimet e ankueses haptazi vërehet se e njëjta ose nuk ka njohuri të mjaftueshme të dispozitave procedurale ose keqpërdore autorizimet e saj në procedurë për të ushtruar presion të pajustificueshëm ndaj gjyqtarës që çështja të procedohet ashtu siç i konvenon asaj, sepse nga shkresat e lëndës rezulton se gjyqtarja ka respektuar dispozitat procedurale në tërësi dhe janë plotësisht të qëndrueshme sqarimet e saj, të dhëna në deklaratën me shkrim.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndër të tjera përcakton, se: *“masave disiplinore u nënshtrohen gjyqtarët dhe prokurorët për shkelje disiplinore në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj..., dhe atëherë nëse gjyqtari dënohet për vepër penale, shkel ligjin, shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar sipas ligjit..., në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë”*.

Në rastin konkret dhe duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi, nuk mund të kërkohet iniciim i procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në rast se nuk përmbushen kushtet e përcaktuara si më lartë, pasi autoriteti kompetent vlerëson se me veprimet saj, gjyqtarja nuk ka shkelur procedurat gjyqësore, aktet ligjore apo Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, dhe këto veprime nuk mund të hynë në kategorinë e shkeljeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi si bazë për iniciim të procedurës disiplinore.

Ndershmëria dhe moraliteti gjyqësor, padyshim që përbëjnë elementet kryesore të integritetit, dhe gjyqtari jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare por gjithmonë duhet të veprojë me ndershmëri dhe në mënyrë të denjë për pozitën gjyqësore, siç përcaktohen edhe me Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, megjithatë në rastin konkret sipas fakteve të kësaj çështje dhe shkresave të lëndës në bazë të të cilës është kërkuar inicim i procedurës disiplinore, gjyqtarja në asnjë rast nuk ka vepruar në kundërshtim me rregullat apo dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë shkeljet e detyrës zyrtare, integritetit profesional apo etikës gjyqësore.

Autoriteti i gjykatës vlerëson se në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, pretendimet e paraqitura, janë pretendime të natyrës së shkeljeve procedurale dhe nuk mund të konstatohet se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore apo të ketë vendosur me subjektivizëm, njëanshmëri apo të ketë zbatuar gabimisht dispozitat ligjore, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtarja ka bërë shkelje gjatë trajtimit të rastit, andaj të njëjtat mbeten në nivel të supozimeve dhe si e tillë ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore.

Autoriteti kompetent për inicim të procedurës disiplinore, nuk ka kompetencë që të vlerësoj apo komentojë vendimet e gjyqtarëve, për të cilat vetëm gjyqtarët janë të autorizuar për veprimet dhe vendimet që marrin, kompetencë kjo e cila i takon Dhomës të Shkallës së Dytë e cila vlerëson nëse shkalla e parë ka zbatuar në mënyrë të gabuar apo ka shkelur ligjin, në një rast të caktuar.

Për më tepër një pjesë e pretendimeve në ankesë i referohet sqarimeve të dispozitave ligjore dhe interpretimit të ligjit nga paraqitësi i kërkesës, apo shkeljes së tyre me rastin e marrjes së vendimit, udhëzimeve se si do duhej të vlerësoheshin faktet dhe në asnjë rast nuk paraqiten pretendime apo rrethanat të cilat mund të mbështeten në fakte dhe prova për shkelje të supozuar nga ana e gjyqtarës, me qëllim të inicimit të procedurës disiplinore, andaj autoriteti kompetent vë në pah se pretendimet për shkelje procedurale apo aplikim të gabuar të dispozitave ligjor mund të mund të atakohen në procedura gjyqësore në Dhomat e Shkallës së Dytë, e cila kujdeset sipas detyrës zyrtare edhe për zbatimin e të drejtës materiale dhe shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe asaj përmbartimore, por të njëjtat nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Lidhur me pretendimet për njëanshmëri të gjyqtares, Autoriteti Kompetent pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, nuk ka arritur të provojë pretendimet për njëanshmëri, pasi nga parashtruesi me rastin e paraqitjes së ankesës nuk është ofruar asnjë provë apo fakt me të cilën argumentohet shkelja e pavarësisë së gjyqtarit apo njëanshmëria e saj.

Për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, dhe pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, si dhe legjislacionit në fuqi.

“Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, përcaktohet me nenit

Rrjedhimisht nga faktet e konstatuara në shkresat e rastit dhe vlerësimit të deklarimeve të palëve nuk është gjetur asnjë sjellje e gjyqtares e cila do të vinte në dyshim integritetin e saj apo sjelljen profesionale si bazë për iniciimin e procedurës disiplinore, andaj si e tillë ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti kompetent ka gjetur se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, dhe si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

AD.GJKK.nr.02/2024, më datë 02.09.2023

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale

Iu dërgohet:

- Marigona I. Gashi – Parashtruesi i kërkesës
- Albert Zogaj – Kryesues i KGjK
- Avokati i Popullit
- V.D.. – Gjyqtare e Gjykatës Komerciale